

**Rregullore për
Rekrutimin e Stafit akademik**

e

Akademisë “Evolucion”

Prishtinë

2018

Në bazë të Statutit të Akademisë "Evolucion" (në tekstin e mëtejshëm: "AE"), Bordi i Drejtorëve (në tekstin e mëtejshëm "BD") i Akademisë "Evolucion" në seancën e mbajtur në Prishtinë më 20.12.2018 miraton këtë:

RREGULLORE PËR REKRUTIMIN E STAFIT AKADEMIK E AKADEMISË "EVOLUCION"

Neni 1 (Stafi Akademik i AE)

- 1.1. Stafi akademik i AE përbëhet nga Ligjërues dhe Asistentë me orar të plotë (të rregullt) dhe me orar të pjesshëm (të angazhuar) si dhe Ligjërues vizitorë.
- 1.2. Propozimet për rekrutimin e stafit akademik janë përgjegjësi e Departamenteve. Këshilli Akademik shqyrton, miraton propozimet dhe i përcjell ato në Bordin e Drejtorëve për miratim.
- 1.3. Stafi akademik në Akademi rekrutohet në bazë të konkurrencës në përputhje me kriteret e vlerësimit të përcaktuara nga Këshilli Akademik.
- 1.4. Marrëdhëniet me stafin akademik rregullohen sipas legjislacionit në fuqi dhe kontratës së punës.
- 1.5. Kontrata ndërmjet stafit akademik dhe Akademisë është përpiluar duke zbatuar normat e Ligjit të Punës së Republikës së Kosovës, Ligjit për Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës dhe Statutit të Akademisë.

Neni 2 (Procedura e shpalljes dhe aplikimit)

2.2. Administrata e Akademisë shpall vendet e lira të punës, llojin e pozitës së lirë (të plotë ose të pjesshme) dhe të gjitha karakteristikat dhe kushtet e tjera që duhet të plotësohen nga kandidatët për të aplikuar për një pozitë të lirë. Vendet e lira të punës shpallen publikisht në faqen e internetit të Akademisë, portalet publike të internetit dhe eventualisht në gazeta ditore me qarkullim kombëtar dhe. Kohëzgjatja e shpalljes për pozitën e lirë është së paku 15 ditë. Në të njëjtën kohë, në shpallje njoftohen qartë afatet e aplikimeve dhe procedurave.

2.3. Kandidatët duhet të dorëzojnë në Zyrën e Drejtorit Akademik formularin e aplikimit (nëse është e aplikueshme) dhe së paku katër dosje që përmbajnë Curriculum Vitae, fotokopje të diplomave dhe certifikatave dhe veprave shkencore / artistike.

2.4. Pas paraqitjes së dosjeve të konkursit, kandidatët vlerësohen nga komisioni ad-hoc i përzgjedhjes, i cili harton një raport që tregon rezultatet e konkurrimit. Pas validimit të rezultateve të konkursit nga Këshilli Akademik, punësimi i ligjëruesve/asistentëve të rinj bëhet me lidhjen e kontratës së punës me Akademinë, e përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv dhe detyrat e postit regjistrohen në përshkrimin e punës.

2.5. Udhëheqësit e departamenteve akademike zgjidhen nga Bordi i Drejtorëve në mesin e anëtarëve të stafit akademik.

Neni 3

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 20.12.208.



Kryesuesi i BD

Besnik Shatri